



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANË

Nr. 12507/7760/2979/805 Regj. Themeltar
Datë 20.04.2016 e Regjistrimit

Nr. 450 Vendimi
Datë 26.02.2020 e vendimit

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët :

KRYESUESE : FJORALBA PRIFTI
ANËTAR: ARJAN QAFA
ANËTARE: ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)

Asistuar nga sekretare gjyqësore [REDAKTUAR] sot në Tiranë, më datë 26.02.2020, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me Nr. 12507/7760/2979/805 regjistri themeltar, datë 20.04.2016 regjistrimi që i përket palëve:

PADITËSE: [REDAKTUAR]

E PADITUR: Ministria e Arsimit dhe Sportit.

PERSON I TRETË: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI: Konstatimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, gjendjes shëndetësore dhe shtatëzanië si dhe detyrimin për zbatimin e vendimit Nr. 114, datë 27.07.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për palën e paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndreqja e pasojave të ardhura si pasojë e sjelljes diskriminuese. Caktimi i dëmshpërblimit moral (financiar) për diskriminimin e kryer dhe pagesa e këtij dëmshpërblimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

BAZA LIGJORE: Neni 7, 15-18 e vijues të Ligjit Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”;
Neni 1, 2, 3, 7 pika 1, neni 32 pika 1 germa a), 34, 37 dhe 38, të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
Neni 31, 32, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile;
Neni 9, 20, 115-126 e vijues, 137, të Kodit të Procedurave Administrative;
Neni 67, i Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”;

Neni 107, i Kodit të Punës;
Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin Nr. 746 (80-2015-740), datë 22.02.2016 ka vendosur:

1. *Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*
2. *Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.*
3. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmyja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, afat që për palët në mungesë nis nga dita e marrjes dijeni.*

Kundër vendimit Nr. 746 (80-2015-740), datë 22.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim paditësja [REDAKTUAR] e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit Nr. 746 (80-2015-740), datë 22.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Paditësja [REDAKTUAR] në janar të vitit 2010 ka nisur punën si punonjëse pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjatë vitit 2014 ka qenë shtatëzanë dhe si pasojë e gjendjes shëndetësore, si dhe të fëmijës ende të palindur ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve disa raporte mjekësore.
Ministria e Arsimit dhe Sportit pa marrë në konsideratë asnjë nga kërkesat e saj ligjore me datë 31.12.2015 ka mbyllur marrëdhëniet e saj të punës me këtë institucion në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu ky institucion ka mbajtur padrejtësisht dhe në mënyrë abuzive deri me 10.04.2015, pra më shumë se katër muaj, librezën e punës megjithë kërkesat me shkrim të përsëritura nga ana e paditëses drejtuar këtij institucioni.
Kërkesat me shkrim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe shkresa “Kthim përgjigje” e po këtij institucioni me nr. 1775/2 prot, datë 03.04.2015, të cilën e ka marrë me postë me datë 10.04.2015 janë depozituar në dosje.
- Sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar, i cili është përdorur si bazë ligjore nga i padituri për kalimin e paditëses në listë pritje (31.12.2013), parashikohet në nenin 23, pika 2 “Mbyllja dhe ristrukturimi” se: “Në rastet e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike, nëpunësve civil, vendet e të cilëve janë deklaruar të tepërt do t’u ofrohet një vend i të njëjtit nivel në një ministri apo institucion tjetër të administratës publike qendrore apo vendore, ose në pamundësi një vend i një niveli më të ulët. Nëpunësi civil vazhdon të gëzojë të drejtat e vendit të tij të mëparshëm deri sa atij t’i ofrohet një vend tjetër, por jo për më tepër se 1 vit...”.
- Paraqitja e raporteve mjekësore pranë këtij institucioni duhet të ishte marrë parasysh dhe duhet të ishte trajtuar sipas përcaktimeve ligjore. Në bazë të nenit 27, pika 1 dhe 2 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet që për sa kohë personi është i siguruar përfiton të ardhura për barrë-lindjeje.
- Për shkak të diskriminimit që i është bërë për shkak të gjinisë, të gjendjes shëndetësore, si dhe për shkak të shtatëzanisë i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

me anë të ankesës nr. 23, datë 18.03.2015. Komisioneri, pasi ka konstatuar diskriminimin e kryer ndaj paditëses nga e paditura Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe punonjësit e kësaj ministrie, më ka me ka dërguar një kopje të vendimit nr. 114, datë 27.07.2015, ku është vërtetuar dhe konstatuar diskriminimi i kryer ndaj meje nga ana e të paditurës.

- Gjykata për të krijuar bindjen e saj në hetimin e çështjes, ka thirrur dy ekspertë: një ekspert psikolog dhe një ekspert vlerësues. Këto ekspertë janë shprehur nëpërmjet raporteve përkatëse të ekspertimit.
- Në konkluzionet e raport vlerësimit psikologjik, eksperti psikolog shprehet që: *“Dëmi moral ekzistencial tek znj. [REDAKTUAR] për shkak të veprimeve të palës së paditur, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ku konstatohet diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes shëndetësore dhe shtatëzanisë, vlerësohet të jetë në nivel maksimal”*. Në raportin e tij, eksperti vlerësues ka arritur në përfundimin që dëmshpërblimi që duhet të paguajë i padituri për dëmin e shkaktuar ndaj paditësit duhet të jetë në vlerën [REDAKTUAR] lekë.
- Gjykata duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për dëmshpërblimin, duke nisur që nga Kushtetuta, Kodi Civil (mund të përmendim nenet 608, 625, 640 e vijues të këtij kodi), aktet e tjera ligjore e nënligjore, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu në kuadër të përafrimit të legjislacionit, por edhe të praktikave gjyqësore me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duhet të merret në konsideratë edhe ky legjislacion.
- Nga ana e të paditurit Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk është dorëzuar asnjë provë për të kundërshtuar konstatimin e diskriminimit, ndërkohë që pretendimet e saj nuk janë mbështetur në asnjë argument ligjor. E paditura nuk ka paraqitur argumente të arsyeshme, profesionale dhe të bazuara në ligj për kundërshtimin e akteve të vlerësimit të ekspertëve. Gjykata në mënyrë të padrejtë dhe të paarsyetur ligjërisht ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.
Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar në mënyrë të gabuar dhe të pambështetur se paditësja ka depozituar më parë dy kërkesë-padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, më datë 20.03.2014 dhe më datë 25.05.2015 me të njëjtin objekt gjykimi. Është lehtësisht e provueshme që asnjë nga këto padi nuk kanë për objekt gjykimi diskriminimin. Gjykata ka deformuar faktet, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme.
- Më tej në vendimin e saj, gjykata ka arsyetuar në mënyrë aspak profesionale dhe në kundërshtim me ligjin, që ligji i ri Nr. 152/2013 nuk e njeh listën e pritjes dhe paditësja thjesht për efekt të ligjit të vjetër në kohën e të cilit u largua nga vendi i punës do të vazhdonte të merrte pagesën e listës së pritjes.
Për këtë arsye sipas gjykatës, paditësja nuk mund të pretendonte që t’i shtyhet lista e pritjes për shkak të disa raporteve të barrë-lindjes, të cilat ajo i ka sjellë pasi ka përfunduar lista e pritjes.
Këto arsyetime janë jonormale për një institucion, i cili duhet të jetë profesional dhe i cili duhet të marrë vendime mbi bazën e bindjes mbi ligjshmërinë apo jo të arsyeve që e çojnë në marrjen e tyre dhe nuk mund të arsyetohet me një “thjesht” apo me një “për shkak të disa raporteve”.
- Gjykata pranon që paditësja ka qenë në marrëdhënie pune, gjithashtu pranon edhe ekzistencën e raporteve (të cilat janë lehtësisht të verifikueshme në protokollin e të paditurit dhe në provat e paraqitura), por i bie shkurt me një “thjesht”.

- Është e thjeshtë të diskriminosh, është e thjeshtë të thuash edhe për shkak të disa raporteve, por gjykata nuk është për t'i rënë gjërave thjesht, por është për të kryer detyrën e saj me profesionalizëm dhe me përgjegjësi.
Gjykata pranon nenin 107, të Kodit të Punës, i cili parashikon pavlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës të njoftuar nga punëdhënësi për periudhën gjatë së cilës gruaja pretendon për të përfiturar të ardhura nga sigurimet shoqërore në rast lindje apo birësimi dhe pastaj vazhdon me arsyetimin që në kohën e daljes në listë-pritje ka qenë në fuqi ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", i ndryshuar, duke arsyetuar në kundërshtim të hapur me ligjin të cilin vetë citon, se parashikimet e Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës nuk janë të aplikueshme në këtë rast.
Nuk e dimë se ku e dërgon gjykata pikën 3, të nenit 1 "Objekti dhe qëllimi" të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", i ndryshuar, i cili shprehimisht thotë: "Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga ky ligj, do të zbatohet Kodi i Punës dhe legjislacioni përkatës".
- Gjykata vendos përciptas dhe në mënyrë subjektive, në kundërshtim të hapur me ligjin, të cilin vetë e referon.
Gjykata i referohet vendimit Nr. 4029, datë 15.07.2015 në mënyrë aspak profesionale dhe në kundërshtim të hapur me ligjin, pasi ky vendim nuk është i formës së prerë në kohën në të cilin gjykata i referohet, si dhe ky vendim nuk ka për objekt diskriminimin, pra nuk mund të përdoret në asnjë rast nga gjykata si një arsyetim i ligjshëm.
- Gjykata thotë që nuk i është paraqitur asnjë raport shëndetësor, duke e ditur që këto raporte i janë dorëzuar të paditurës, ndërkohë që gjykata në asnjë moment nuk i ka kërkuar këto raporte, pavarësisht se i ka pasur të gjitha referencat përkatëse dhe sidomos që këto raporte janë administruar nga Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe janë të vërtetuara prej komisionerit në vendimin e tij dhe në provat dhe parashtrimet e paraqitura nga komisioneri si person i tretë në këtë proces.
- Gjykata në mënyrë të gabuar vlerëson që vendimi Nr. 114, datë 22.07.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është dhënë ndërkohë që kjo çështje në këtë kohë ishte në proces gjykimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që nuk ka asnjë çështje në gjykim apo të gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me këtë objekt gjykimi.
Me këtë rast gjykata i shmanget gjykimit, duke mohuar një ndër të drejtat themelore të individit për t'iu drejtuar gjykatës dhe për një proces të ligjshëm dhe të pavarur.
- Gjykata ka caktuar vetë ekspertët, të cilët ajo i ka menduar të aftë për të dhënë përgjigje mbi çështjen dhe në vendimin e saj i quan aktet e ekspertimit si aludime dhe supozime. Kur gjykata nuk arrin të jetë e sigurtë për vendimet e ekspertëve, nuk sigurohet dhe mendon se ekspertët janë joprofesionistë të fushës mund të kërkojë ekspertë të tjerë. Kjo nuk është kryer nga gjykata. Raportet e ekspertëve e vërtetojnë dëmin e shkaktuar, si dhe provojnë ekzistencën e lidhjes shkakësore për shkaktimin e dëmit. Pra ekziston dëmi, veprimi i paligjshëm dhe lidhja shkakësore (sjellja e paligjshme, faji, pasoja e ardhur).
Ndërkohë që gjykata e mbyll me një orientim për paditësin, për t'iu drejtuar një padie me natyrë administrative, ndërkohë që vetë është gjykata, e cila ka kompetencën për të gjykuar çështjet me natyrë administrative.

Me vendimin e datës 23.03.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e ankimit të paditëses [REDAKTUAR], ndaj vendimit të sipërcituar.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi u njoh me relacionin e gjyqtares Fioralba Prifti,
U njoh me ankimin e palës paditëse [REDAKTUAR], me të cilën është kërkuar ndryshimi i vendimit Nr. 746 (80-2015-740), datë 22.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimi i kërkesë padisë,
si dhe pasi verifikoi të plotësuara kushtet e pranueshmërisë së ankimit,
si u njoh me parashtrimet me shkrim të paditëses, të depozituara në sekretari më datë 14.02.2020, me të cilat është kërkuar sipas ankimit,

VËREN

Se Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim çështjen mbi ankimin e palës paditëse [REDAKTUAR], e cila kundërshton vendimin objekt ankimi me të cilin është vendosur rrezimi i kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

I.Rrethanat e çështjes.

1. Paditësja [REDAKTUAR] me vendimin Nr. 756/7 prot, datë 10.06.2013 është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike si nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin "Përgjegjëse sektori", në Sektorin e Analizës së Politikave dhe Strategjive në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare të Ministrisë së Arsimit.
2. Sipas shkresës Nr. 1820/2 prot, datë 06.12.2013 Departamenti i Administratës Publike ka njoftuar palën e paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit se në përgjigje të shkresës së saj nr. 1470 prot, datë 28.11.2013 ka miratuar kalimin në listën e pritjes të paditëses [REDAKTUAR] në kuadër të ristrukturimit.
3. Me vendimin Nr. 1470/13 prot, datë 12.12.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është vendosur kalimi në listë pritje i paditëses [REDAKTUAR], si pasojë e suprimimit të këtij pozicioni dhe ndryshimeve në organikë, në kuadër të ristrukturimit të institucionit. Sipas përmbajtjes së vendimit është përcaktuar që kalimi në listën e pritjes të fillojë në datën 16.12.2013 dhe dorëzimi i detyrës të bëhet brenda datës 15.12.2013.
4. Me shkresën Nr. 2203/5 prot, datë 27.12.2013 paditësja është vënë në dijeni se për shkak të kryerjes së pjesës së mbetur të lejes vjetore për vitin 2013, kalimi në listën e pritjes do të fillojë më 31.12.2013.
5. Paditësja duke mos qenë dakord me sa më sipër për kalimin në listën e pritjes, për mbrojtjen e të drejtës së cenuar i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padinë me objekt: "Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ me lëndë "Njoftim" nr. 2203/5, datë 27.12.2013 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; "Propozim për sistemimin në kuadër të ristrukturimit" nr. 1441/7, datë 26.11.2013 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; "Vendim për kalimin në listën e pritjes" nr. 1470/13, datë 12.12.2013 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; Dhe e pasojave të shkaktuara prej tyre. Pavlefshmëri e aktit administrativ nr. 1820/2 prot, datë

06.12.2013 të Departamentit të Administratës Publike dhe pasojave të shkaktuara prej tij ndaj meje. Kthim në vendin e punës ose në vendet e lira (përgjegjës sektori) të shpallura nga Departamenti i Administratës Publike, për të cilat plotësohen kriteret përkatëse. Pajisja nga Departamenti i Administratës Publike dhe konfirmimin e statusit të nëpunësit civil”.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 3258, datë 16.06.2014 ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paraqitur nga paditësja [redacted] Shfuqizimin vendimit “Për kalimin në listë pritje” të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit datë 12.12.2013, si dhe shkresës nr. 1820/2 prot, datë 06.12.2013 të Departamentit të Administratës Publike, për pjesën që bën fjalë për paditësen [redacted] Kthimin e paditëses [redacted] në vendin e mëparshëm të punës “Përgjegjës Sektori” ose në një vend të barazvlefshëm me të, të shpallura të lira nga Departamenti i Administratës Publike; Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit...” Vendimi i mësipërm rezulton të jetë lënë në fuqi nëpërmjet vendimit Nr. 2482, datë 19.11.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

7. Po ashtu midis palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë zhvilluar edhe një proces gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padinë me objekt: “Pavlefshmëri të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës; Pezullimi i afatit të listës së pritjes, për kohën që zgjat leja e lindjes dhe lejet e paralindjes; Detyrimi i institucionit përgjegjës Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për pagesën e raporteve për paafhtësi të përkohshme në punë nr. regjistri 546, datë 06.01.2015, nr. regjistri 1319, datë 29.12.2014, nr. regjistri 1294, datë 22.12.2014”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 4029, datë 15.07.2015 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë me nr. 4249 akti, me palë paditëse [redacted]”.

Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin Nr. 3279, datë 10.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

8. Paditësja [redacted] i është drejtuar personit të tretë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me ankesën Nr. 23, datë 18.03.2015, kundër palës së paditur Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë, shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore.

9. Personi i tretë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vijuar me hetimin administrativ, ku me shkresën nr. 265/1 prot, datë 17.03.2015 ka njoftuar palën e paditur dhe njëkohësisht i ka kërkuar informacion në lidhje me rastin e paditëses [redacted]

10. Pala e paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet shkresës nr. 2561/1 prot, datë 24.04.2015 bën me dije se: “...Në bazë të urdhrin nr. 186, datë 18.10.2013 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, institucioni hyri në procesin e ristrukturimit. Për shkak të suprimimit të vendit të punës dhe pamundësisë për ta sistemuar në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel apo të një niveli më të ulët, më datë 31.12.2013 znj. [redacted] kaloi në listën e pritjes së nëpunësit civil. Duke filluar nga data 22.12.2014, pra vetëm 9 ditë para përfundimit të listës së pritjes, znj. [redacted] ka paraqitur me protokoll në MAS raporte mjekësore për “partus premature”.

Në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, parashikohet pagesa për një periudhë një vjeçare e nëpunësit në listën e pritjes. Gjatë periudhës së listës së pritjes, punonjësi

nuk ka asnjë detyrim të paraqesë në institucion raporte mjekësore, pasi raporti justifikon një mungesë në punë, ndërsa gjatë listës së pritjes nëpunësi nuk ushtron asnjë detyrë, thjesht paguhet për një vit.

Konsideruar faktin që znj. [REDAKTUAR] ka paraqitur në MAS raporte mjekësore gjatë periudhës që ishte në listën e pritjes, pa pasur asnjë detyrim për të justifikuar mungesën në punë, pasi paguhej në listën e pritjes së nëpunësit civil, me shkresën Nr. 1775, datë 03.04.2015, znj. [REDAKTUAR] është njoftuar zyrtarisht për të marrë librezën e punës së mbyllur në datën 31.12.2014, të cilën e interesuara e ka marrë në dorëzim në datën 14.04.2015. Gjithashtu, dëshirojmë t'ju vëmë në dijeni se nëse gjatë periudhës së listës së pritjes, znj. [REDAKTUAR] do të kishte paraqitur në MAS raportin për lejen e lindjes, institucioni ynë do të kishte ndërmarrë të gjitha hapat në respekt të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".

10. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 23, datë 18.03.2015 të paraqitur nga paditësja [REDAKTUAR], me vendimin nr. 114, datë 27.07.2015 ka vendosur:

"Konstatimin e diskriminimit, për shkak të shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore të znj. [REDAKTUAR] nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

2. Referuar pikës 2 të këtij vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për shtyrjen e listës së pritjes për znj. [REDAKTUAR] për aq kohë sa janë dorëzuar raportet mjekësore, si dhe ndryshimet përkatëse të reflektohen në librezën e saj të punës;

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit dhe Sportit të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi;

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2011 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera ka arsyetuar se: "Në interpretim të nenit 23, pika 2, të ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", rezulton se përgjatë 1 viti që nëpunësi është në listë pritjeje, vazhdon të gëzojë të drejtat e vendit të tij të mëparshëm të punës, por jo më tepër se 1 vit. Këtu e vëmë theksin sidomos tek të drejtat me karakter financiar. Kështu, institucioni e paguan për 1 vit, nëpunësin në listë pritjeje, me pagën që i përket pozicionit të mëparshëm të punës, duke derdhur njëkohësisht edhe shumën përkatëse pranë ISSH-së në emër të punonjësit.

Pra, nëpunësi që është në listë pritjeje, përgjatë një viti është i siguruar, sikurse çdo nëpunës tjetër. Pra, gjatë periudhës 31.12.2013 - 31.12.2014, ankuesja ka gëzuar të gjitha të drejtat e pozicionit të saj të mëparshëm të punës, përfshirë këtu pajisjen me raport shëndetësor, sikurse çdo punonjës tjetër që është efektiv.

Pra, në këtë kontekst gjykojmë që raportet mjekësore "partus premature" të dorëzuar nga ankuesja, duke filluar nga data 23.12.2014 e në vijim, duhet të ishin marrë parasysh prej MAS, duke shtyrë edhe listën e pritjes për aq kohë sa kanë zgjatur këto raporte, si dhe raportet e barrë-lindjes të depozituara në muajt vijues. Nga verifikimet e kryera pranë MAS rezulton se nuk ka pasur asnjëherë ndonjë rast analog me atë të znj. [REDAKTUAR]

Për zgjidhjen e kësaj situate, MAS ka kërkuar edhe mendimin e Departamentit të Administratës Publike, institucion i cili është përgjegjës për marrëdhëniet financiare me punonjësin që është në listë pritjeje menaxhohet nga vetë institucioni, duke mos i dhënë drejtim kësaj çështjeje. Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se znj. [REDAKTUAR] është ekspozuar ndaj një

trajtimi të padrejtë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në krahasim me punonjës të tjerë të këtij institucioni.

Ky trajtim ka lidhje të drejtpërdrejtë me gjendjen e saj shëndetësore dhe shtatëzaninë.

Në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi moral (financiar), ndaj ankuesja duhet t'i drejtohet gjykatës, për të përfituar këtë dëmshpërblim".

11. Ky vendim nëpërmjet shkresës nr. 701 prot, datë 27.07.2015 i është njoftuar palës së paditur, e cila me shkresën nr. 5710/1 prot, datë 27.08.2015 i bën me dije personit të tretë se: "Znj. [REDAKTUAR] për çështjen që ka parashtruar pranë institucionit tuaj, ka ngritur padi kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe aktualisht pritet të shqyrtohet në Gjykatën Administrative të Apelit, pas ankimit të depozituar nga znj. [REDAKTUAR] pranë kësaj gjykate. Bazuar në nenin 36, të K.Pr.Civile, ku parashikohet se asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, për sa kohë që çështja është në juridiksionin gjyqësor, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund të kryejë asnjë veprim në lidhje me ankesën e paraqitur pranë institucionit tuaj nga znj. [REDAKTUAR]."

II.Procedura gjyqësore dhe vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

12. Padiësja [REDAKTUAR] më datë 14.09.2015 i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar konstatimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, gjendjes shëndetësore dhe shtatëzanisë si dhe detyrimin e palës së paditur për zbatimin e vendimit Nr. 114, datë 27.07.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për palën e paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe ndreqjen e pasojave të ardhura si pasojë e sjelljes diskriminuese me caktimin e dëmshpërblimit moral për diskriminimin e kryer dhe pagesa e këtij dëmshpërblimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

13. Padiësja gjatë gjykimit në shkallë të parë ka parashtruar të njëjtat shkaqe me ato të parashtruara në ankimin e sipërcituar.

14. Pala e paditur gjatë gjykimit në shkallë të parë ka prapësuar se kjo padi është ngritur jashtë afateve të përcaktuara në ligjin Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe bazuar në nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile përbën gjë të gjykuar, pasi kjo çështje është ngritur edhe më parë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe konkretisht është rrëzuar me vendimin nr. 4029, datë 15.07.2015, pasi është një padi për të cilën kërkohet diskriminimi për të njëjtin shkak ligjor dhe të njëjtat palë ndërgjyqëse, pra ndërkohë që nuk ka një vendim të formës së prerë të gjykatës në lidhje me pezullimin e listës së pritjes për shkak të raporteve dhe për pagesën e tyre, por është vendosur e kundërta duke u rrëzuar padia.

Ligji i ri i nëpunësit civil Nr. 152/2013 i ndryshuar nuk e njeh listën e pritjes dhe i konsideron pa status nëpunësi, punonjësit e dalë në listë pritje me ligjin e vjetër të nëpunësit civil. Pretendimi se neni 107 i Kodit të Punës ka parashikuar se është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi për periudhën gjatë së cilës gruaja pretendon për të përfituar të ardhura

nga sigurimet shoqërore në rast lindje apo birësimi është i pabazuar, pasi marrëdhënia juridiko civile e paditëses rregullohej në bazë të ligjit Nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" i ndryshuar.

Bazuar në nenin 36, pika 5, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" paditësja ka detyrimin të provojë diskriminimin në kushtet e punës, paditësja nuk mundet objektivisht të provojë diskriminimin në kuptim të këtij ligji, pasi nuk ndodhet në kushtet e përcaktuara në këtë ligj, atëherë përfundimisht Ministria e Arsimit dhe Sportit kërkon rrëzimin e kërkesë padisë, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

15. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin objekt ankimi ka vendosur rrëzimin e padisë duke arsyetuar ndër të tjera se:

- i. Në lidhje me ekzistencën e dëmit në situatën objekt konflikti gjyqësor ka evidentuar se paditësja ka pretenduar se si pasojë e për shkak të diskriminimit që i është bërë për shkak të gjinisë, të gjendjes shëndetësore, si dhe për shkak të shtatëzanisë, asaj nuk i janë njohur periudhat e raporteve mjekësore dhe lindja e së drejtës për përfitim të barrë-lindjes. Ky pretendim i paditëses vjen në kundërshtim me provat e paraqitura dhe administruara nga ana e gjykatës në gjykimin e çështjes. Gjatë gjykimit u provua se paditësja në kërkesë padinë e saj pretendon se ajo ka depozituar në MAS raportet mjekësore më datë 23.12.2014 dhe me datë 29.12.2014 e në vazhdim dhe nuk ka marrë përgjigje nga MAS, duke iu shkaktuar për këtë shkak një dëm për shkak të diskriminimit të saj për arsye gjinore e shëndetësore siç është shtatëzania.
- ii. Provohet se paditësja ka depozituar edhe më parë dy kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht me datë 20.03.2014 dhe me datë 25.05.2015, me të njëjtin objekt gjykimi, para gjyqtarit [REDAKTUAR] dhe më tej para gjyqtares [REDAKTUAR], nëpërmjet të cilave ka kërkuar kundërshtimin e aktit administrativ të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, pavlefshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, pezullimin e afatit të listës së pritjes për kohën që zgjat leja e lindjes dhe lejet e paralindjes, detyrimin e institucionit përgjegjës Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për pagesën e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë dhe këto çështje janë aktualisht objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
- iii. Pas kalimit të paditëses në dhjetor 2013 në listë pritje, ka hyrë në fuqi ligji Nr. 152/2013. Duke qenë se ligji i ri nuk e njeht listën e pritjes, atëherë paditësja thjesht për efekt të ligjit të vjetër në kohën e të cilit u largua nga vendi i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe suprimimit të vendit të saj të punës, do të vazhdonte të merrte pagesën e listës së pritjes, por në kuptim të këtij ligji dhe nenit 67 të këtij ligji, paditësja nuk gëzonte më status nëpunësi, pasi nuk ishte nëpunëse civile. Për këtë arsye paditësja nuk mund të pretendonte që t'i shtyhej lista e pritjes për shkak të disa raporteve të barrë-lindjes, të cilat ajo i ka sjellë pasi ka përfunduar lista e pritjes.
- iv. Pretendimi se neni 107 i Kodit të Punës e ka parashikuar se është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi, për periudhën gjatë së cilës gruaja pretendon për të përfituar të ardhura nga sigurimet shoqërore në rast lindje apo birësimi është i pabazuar, pasi marrëdhënia juridiko civile e paditëses rregullohej në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" i ndryshuar. Ky ka qenë ligji material në fuqi në kohën e kalimit në listë pritje të paditëses. Në këtë rast parashikimet e Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës nuk janë të aplikueshme në këtë rast.

- v. Gjykata ka vlerësuar se gjatë periudhës së listës së pritjes që parashikohej sipas ligjit Nr. 8549/1999, paditësja nuk ishte në përmbushje të detyrave të saj funksionale, për këtë arsye lejet e paralindjes nuk kanë efekt në gjendjen juridike të paditëses si nëpunëse civile, pasi kalimi në listë-pritje është bërë me datë 01.01.2014 dhe me ligjin e ri nuk njihet më lista e pritjes, pra paditësja nuk e disponon më statusin e nëpunëses civile. Në këto kushte paditësja nuk përmbushte kushtet e parashikuara në ligjin nr. 10221/2010, sepse në datë 01.01.2014 në të cilën paditësja doli në listë pritje ajo nuk ka qenë shtatëzanë. Në këto kushte gjykata vlerëson se nuk provohet që paditësja të jetë diskriminuar për shkak të gjinisë, as gjendjes shëndetësore dhe as shtatëzanisë, sepse këto çështje janë trajtuar tashmë nga kjo gjykatë, e cila së fundmi me vendimin nr. 4029, datë 15.07.2015 ka trajtuar kërkimin për detyrimin e MAS për pagesën e raporteve për paafhtësi të përkohshme në punë etj duke e rrëzuar atë.
- vi. Gjykata ka vlerësuar se paditësja nuk rezulton të jetë larguar nga puna as sepse ishte femër, as për shkak të gjendjes shëndetësore dhe as shtatëzanisë, pasi ajo është larguar më parë nga puna, siç u trajtua më lart dhe për shkak të ristrukturimit të institucionit kur ishte në gjendje të mirë shëndetësore (të paktën prej saj nuk ishte paraqitur asnjë raport shëndetësor për të kundërtën), si dhe kur nuk rezultonte shtatëzanë.
- vii. Gjykata ka vlerësuar se vendimi Nr. 114, datë 22.07.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është dhënë ndërkohë që kjo çështje në këtë kohë ishte në proces gjykimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe në bazë të nenit 36, të K.Pr.Civile asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Pra, për sa kohë kjo çështje është nën juridiksionin gjyqësor, nuk mund të kalonte nën juridiksionin administrativ dhe të shqyrtohej nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, prandaj MAS me shkresën nr. 5710/1 prot, datë 27.08.2015 i ka kthyer përgjigje Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që çështja është në juridiksion të gjykatës.
- viii. Në lidhje me kërkimin për shpërblimin e dëmit jopasuror (moral), duke iu referuar përmbajtjes së nenit 608, të Kodit Civil, që të lindë përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit është i nevojshëm që të plotësohen kushtet, elementët dhe kriteret që përcakton ligji. Pra, është e nevojshme të përmbushen dhe të ekzistojnë të katër elementët e shkaktit të dëmit të përmendura më sipër. Për sa kohë që me vendim të formës së prerë nuk është konstatuar paligjshmëria e aktit administrativ, nuk provohet kushti i paligjshmërisë së veprimit. Bazuar në nenin 36, të ligjit nr. 10221/2010, paditësja ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese. Paditësja kishte barrën e provës për të vërtetuar dëmin që i është shkaktuar, që nënkupton dëmin pasuror dhe jopasuror. Akti i ekspertimit i përgatitur nga ekspertët është mbështetur në përlllogaritje të bëra mbi aludime e supozime dhe mbi të gjitha nuk ekziston lidhja shkakësore për shkaktimin e dëmit referuar Kodit Civil dhe këtij vendimi unifikues. Pra në lidhje me sa më sipër, nuk provohet ekzistenca e veprimeve të paligjshme nga ana e palës së paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit e për rrjedhojë nuk mund t'i atribuohet një fajësi autoritetit publik.
- ix. Në këtë kuadër, gjykata vlerëson se duke qenë se mungon provimi gjyqësor i dëmit të shkaktuar, sikurse u tha më sipër, nuk provohet një lidhje shkakësore ndërmjet veprimeve të paligjshme të pretenduara të kryera nga e paditura dhe pasojave të pretenduara që mbeten të paprovuara në gjykim. Referuar nenit 609, të Kodit Civil, duke qenë se në gjykim nuk provohet shkaktimi i një dëmi të pretenduar e po kështu që ky dëm të jetë shkaktuar nga

veprimet apo mosveprimet administrative nga ana e të paditurit, duke mos u provuar as ekzistenca e dëmit, atëherë mbetet e paprovuar edhe lidhja shkakësore midis veprimit dhe mosveprimit dhe dëmit.

- x. Gjykata ka orientuar palën paditëse [REDAKTUAR] që çdo e drejtë që i buron nga ligji për efekt të përfitimit nga barrë-lindja dhe problemet shëndetësore, mund t'i zgjidhë vetëm duke iu drejtuar një padie me natyrë administrative në përputhje me nenin 21, pika 1, të ligjit Nr. 7703/1993 "Për sigurimet shoqërore në R.SH".

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit.

16. Gjykata Administrative e Apelit pasi u njoh me shkaqet e paraqitura në ankim, provat e marra në shqyrtim dhe aktet procedurale arrin në përfundimin se shkaqet e ankimit nuk qëndrojnë pasi vendimi Nr. 746 (80-2015-740), datë 22.02.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material dhe për pasojë duhet të lihet në fuqi duke arsyetuar si vijon:

17. Lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes, gjykata i referohet parimit procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në nenin 37, pika 1 të Ligjit Nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, parim sipas të cilit: "*Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ*".

18. Në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjes, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se në këtë rast me anë të padisë së paraqitur për shqyrtim, pala paditëse kërkon që gjykata të konstatojë paligjshmërinë e veprimeve dhe mosveprimeve të palës së paditur, të cilësuar prej si "diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes shëndetësore dhe shtatëzanisë", paligjshmëri që konsiston në mospranimin e raporteve mjekësore nga pala e paditur dhe mosshyrjen e listës së pritjes tej datës 01.01.2015, kohë në të cilën ajo i përfundonte, pezullim dhe shtyrje që kërkohej prej paditëses për shkak të gjendjes së saj shëndetësore të krijuar pikërisht për shkak të shtatëzanisë. Për shkak të kësaj paligjshmërie, pala paditëse kërkon njëkohësisht dëmshpërblim për diskriminim duke iu referuar dispozitave të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe dispozitave të K.Civil që rregullojnë përgjegjësinë e dëmit.

19. Në lidhje me këtë mosmarrëveshje, Gjykata Administrative e Apelit arsyetohet se:

19.1. Në lidhje me pretendimin e palës së paditur për afatin e paraqitjes së padisë, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky pretendim është i pambështetur në ligj, pasi pavarësisht se me anë të padisë kërkohet të konstatohet paligjshmëria e veprimeve të palës së paditur të kryer në fundin e vitit 2014 e në vijim, në thelb padia është ka si qëllim shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar paditëse nga mosveprimet e pretenduara të paligjshme të palës së paditur. Padia për konstatimin e diskriminimit, referuar nenit 36 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 mund të paraqitet brenda 5 viteve nga dita që ka ndodhur sjellja diskriminuese, ndërsa sipas nenit 34 të këtij ligji dhe nenit 17 të ligjit Nr. 8510/1999 padia për shpërblimin e dëmit i nënshtrohet afatit të parashkrimit 3 vjeçar dhe për pasojë ajo konsiderohet e paraqitur në afat.

19.2 Në lidhje me çështjen nëse paraqitja e një ankese para Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, apo vendimmarrja e komisionerit kuzhtëzon ngritjen e padisë në gjykatë, Gjykata

Administrative e Apelit evidenton se sipas nenit 34 të ligjit nr. 10221/2010 përcaktohet se : “ 2. Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale ... ”, ndërkohë që sipas nenit 37 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit.”

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, Gjykata arrin në konkluzionin se ligji nuk e ka kushtëzuar vendimmarrjen e gjykatës, nga masat që ka kompetencë të marrë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ka njohur paralelisht dy institucione që ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi, si Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ashtu edhe gjykatën, por kjo e fundit ka kompetencën ekskluzive për të vendosur nëse ka shkelje të ligjit nr. 10221/2010 nga organi publik dhe më tej nëse ka vend për dëmshpërblim.

19.3 Në këtë rast barrën e provës për të provuar ekzistencën e diskriminimit e ka pala paditëse në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr. 10 221/2010, ndërsa pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.

Në nenin 34.1 të ligjit përcaktohet se: “1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.; “, ndërsa në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”.

Në nenin 3.1 të ligjit përcaktohet se: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 7.1 të ligjit të sipërpërmendur me titull “Mbrojtja nga diskriminimi” përcaktohet se: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

19.4 Në kreun II të ligjit, me titull “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim” në nenin 12 me titull “Ndalimi i diskriminimit” përcaktohet se:

"1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin I të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) shpalljen e vendeve të lira të punës;

b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;..."

19.5 Gjykata Administrative e Apelit evidenton se pavarësisht mbrojtjes së ofron Kodi i Punës ndaj diskriminimit dhe veprimeve abuzive të punëdhënësit, apo mbrojtjes që ofronte ligji nr 8549/1999, apo ligji Nr. 152/2013, një mbrojtje të pavarur në këtë rast siguron edhe ligji Nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Ky i fundit rregullon çështjen e diskriminimit në përgjithësi dhe mekanizmat mbrojtës në veçanti, mekanizma, të cilat mund të aplikohen në mënyrë të pavarur nga zbatimi i dispozitave të tjera ligjore që ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi.

20. Gjykata Administrative e Apelit referuar dispozitave të sipërpërmendura dhe provave të marra në shqyrtim arrin në konkluzionin se me të drejtë me vendimin objekt ankimi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë janë rrëzuar pretendimet e paditëses për dëmshpërblim për shkak të veprimeve diskriminuese të palës së paditur Ministria e Arsimit dhe Sportit në raport me paditësen me rastin e përfundimit të listës së pritjes dhe mospezullimit të saj për shkak të raporteve mjekësore të paraqitura në këtë kohë nga paditësja.

21. Në arritjen e këtij konkluzioni, ka në konsideratë faktin se me vendim gjyqësor të formës së prerë tashmë (vendimi nr. 4029, datë 15.07.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, i linë në fuqi me vendimin Nr. 3279 datë 10.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit) është rrëzuar padia e paditëses [redacted] me objekt : "Pavlefshmëri të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës; Pezullimi i afatit të listës së pritjes, për kohën që zgjat leja e lindjes dhe lejet e paralindjes; Detyrimi i institucionit përgjegjës Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për pagesën e raporteve për paafësi të përkohshme në punë nr. regjistri 546, datë 06.01.2015, nr. regjistri 1319, datë 29.12.2014, nr. regjistri 1294, datë 22.12.2014". Ky fakt nuk referohet nga pala paditëse në parashtrimet e depozituara në sekretari prej saj, por k apërbërë shkak për dorëheqjen e një prej anëtarëve të trupit gjykues.

22. Nga ana tjetër ,Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se referuar kuptimit që ligji Nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" i jep diskriminimit dhe mbrojtjes prej tij, nuk provohet se në rastin e paditëses, pala e paditur të mos ketë marrë në konsideratë raportet për paafësi të përkohshme në punë nr. regjistri 546, datë 06.01.2015, nr. regjistri 1319, datë 29.12.2014, nr. regjistri 1294, datë 22.12.2014 në pezullimin e listës së pritjes për shkak të gjendjes shëndetësore, shtatëzaniës, apo çdo shkak tjetër me qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë , të drejta këto që kanë të bëjnë me të drejtën për punë dhe sigurime shoqërore të paditëses.

Nga provat e marra në shqyrtim nuk rezulton që pala e paditur të ketë pasur trajtime të ndryshme për raste të njëjta që të mund të krijonin dyshime në këtë rast se ajo ka vepruar në kushtet e diskriminimit ndaj paditëses.

23. Provat e paraqitura nga paditësja para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme që gjykata t'i kalojë barrën e provës palës së paditur për të provuar mungesën e sjelljes diskriminuese në kuptim të nenit 36.6 të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010.

Në rrethanat kur paditësja nuk ka provuar se pala e paditur në mospranimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë dhe në mospezullimin e pagesës së listës së pritjes ka vepruar në kundërshtim me ligjin (duke qenë se pretendimet e saj në lidhje me këtë sjellje të pretenduar të paligjshme janë rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë), Gjykata Administrative e Apelit arrin në konkluzionin se nuk ka të dhëna dhe prova se pala e paditur të ketë kryer një sjellje diskriminuese ndaj paditëses në kuptim të neneve 1, 7 dhe 12 të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010.

24. Në mungesë të sjelljes diskriminuese të palës së paditur ndaj paditëse, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se me të drejtë me vendimin objekt ankimi është rrëzuar edhe kërkesa për dëmshpërblim, pasi kjo kërkesë është e lidhur ngushtësisht me ekzistencën e sjelljes diskriminuese të organit publik.

25. Referuar pretendimeve të paraqitura në ankim në lidhje me çështjen se ekspertët kanë provuar dëmin që i është shkaktuar paditëses, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ekzistenca e dëmit jopasuror, moral dhe ekzistencial nuk përbën shkak për të ngarkuar palën e paditur me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit për aq kohë sa nuk provohet ekzistenca e shkeljes me faj nga ana e kësaj pale, që të përbëjnë shkak për dëmshpërblim, pasi kushtet për ekzistencën e përgjegjësisë jokontraktore janë kumulative.

26. Pretendimet në lidhje me mosmarrjen në konsideratë të vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të pambështetura në ligj e në prova, për shkak se ashtu sikurse u evidentua më sipër, sipas nenit 37 të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010, vendimet e Komisionerit të Mbrojtjes nga Diskriminimi nuk janë të detyrueshme për gjykatën që shqyrton mosmarrëveshjen, pasi është gjykata organi kompetent që vendos nëse ka pasur shkelje të ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

27. Për të gjitha sa u parashtuan më sipër, Gjykata Administrative e Apelit arrin në konkluzionin se shkaqet e ankimit nuk qëndrojnë, vendimi Nr. 746, datë 22.02.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të cilin është rrëzuar padia e paditëses [REDAKTUAR] është i drejtë, i mbështetur në ligj e në prova dhe për pasojë në zbatim të nenit 50.b të ligjit nr. 49/2012 duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50 germa "b" të Ligjit Nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar

VENDOSI

Lënien në fuqi të vendimit Nr. 746, datë 22.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shka llës së Parë Tiranë.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të tij.

U shpall, sot në Tiranë, më datë 26.02.2020.

ANËTARE
ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)
DV

ANËTAR
ARJAN QAJA
DV
E NJEHSUAR ME ORIGINALIN

KRYESUESE
FJORALBA PRIFTI
DV

Kancelari
Leonard Stealy
Stealy

